



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 760/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092), në përbërje nga Vedat Poterqoi Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani Anëtare dhe Kimete Gashi- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga grupi i Operatorit Ekonomik (OE) "V.B Tofaj" me seli në Junik, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i shtratit të Lumit krena", me nr. të prokurimit: 632-22-7920-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna Gjakovë, me datën 27.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. **Anulohet në tërësi** aktiviteti i prokurimit "Rregullimi i shtratit të Lumit krena", me nr. të prokurimit: 632-22-7920-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna Gjakovë.
2. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohen operatorët ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 24.11.2022, Komuna e Gjakovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për pezullim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Rregullimi i shtratit të Lumit krena”, me nr. të prokurimit: 632-22-7920-5-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Komuna Gjakovë.

Me datën 29.11.2022, Operatori Ekonomik, “V.B Tofaj” me seli në Junik ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK Komunën e Gjakovës, më datë 01.12.2022 AK ka pezulluar aktivitetin e prokurimit lartë shënuar, ndërsa me datë 02.12.2022, AK Komuna e Gjakovës, e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE ankues.

Me datën 12.12.2022 Operatori ekonomik “V.B Tofaj” me seli në Junik ka, parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 760/2022, kundër njoftimit për dhënie të kontratës të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, vlerë të madhe, lloji i kontratës: punë, vlera e parashikuar e kontratës: 656 741,41€.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 27.12.2022, eksperti i brendshëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e Operatorit Ekonomik ankues “V.B Tofaj” me seli në Junik me seli në Junik aprovet pjesërisht si e bazuar

- të anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit në mungesë të ofertave përgjegjshme.

Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor ankimor kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, sipas ankesës 760/22 ka të bëjë me kërkesat e dosjes së tenderit pika 8.1&8.2: “Operatori Ekonomik duhet të ketë kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompania në bankë në vlerë prej së paku 200.000,00 euro, ose qasje në kredi të pa kushtëzuar, nga një bankë duke emërtuar projektin për të cilin lejohet kredia”

OE ankues pretendon se letër mbështetja nga banka është e “kushtëzuar” dhe nuk plotëson kërkesën e dosjes së tenderit.

Pas analizimit të shkresave të lëndës/ofertës së OE të rekomanduar për kontratë kemi gjetur se i njëjti ka ofruar letër mbështetje nga banka, përmes cilës banka thotë se do ta mbështes OE me shumën e caktuar “nëse” klienti i plotëson kushtet dhe kriteret e brendshme të bankës për një kreditim të tillë.

Mendimi i ekspertit në rastin konkret është që kjo letër mbështetje nga banka nuk e plotëson kërkesën e dosjes së tenderit për mjete të gatshme ose qasje në kredi të “pakushtezuar”, pasi nuk ofron asnjë garanci/siguri se OE do ti lejohet kredia.

Për më tepër, në të njëjtën letër banka thekson se, nuk ka dhe nuk pranon asnjë përgjegjësi financiare ndaj përfituesit dhe/ose autoritetit kontraktues.

Provë : Letër Mbështetja (e kushtëzuar) nga banka për OE Rosa Komani B.I

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar.

Pretendimi nr.2

OE ankues po ashtu pretendon se OE i rekomanduar për kontratë nuk plotësuar kërkesat për disa pajisje. AK në refuzim të kërkesës për rishqyrtim ka theksuar se përmes sqarimeve shitesë OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar marrëveshje për qera për pajisje. Mendimi ekspertit është se ky sqarim/plotësim i ofertës është në pajtim me nenin 72 par.3 të LPP-së, pasi përmes aktit noterial marrëveshja për qiramarrje mund të verifikohet në mënyrë objektive se ka ekzistuar para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, gjegjësisht marrëveshja dhe noterizimi i kopjes së marrëveshjes mbajnë datën 09.09.2022.

E njëjta situatë është me sqarimet e ofruara nga OE sa i përket licencave dhe diplomave të disa anëtarëve të stafit, ku përmes datës së diplomës ose licencës në mënyrë objektive verifikohet ekzistenca e këtyre dokumenteve para afatit të fundit për dorëzim të tenderit.

I vetmi përjashtim në këtë rast sipas mendimit tonë është CV e ofruar pas hapjes, mirëpo edhe në këtë rast sipas RRUOPP-së e cila ka qenë në fuqi me rastin e inicimit të këtij aktiviteti, për mungesë të CV-së mund të kërkohet informata shitesë.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është vetëm pjesërisht i bazuar.

Pretendimi nr.3

Pretendimi radhës sipas ankesës 760/22 është se OE i rekomanduar ka ndërhyrë në disa dokumente lidhur me kontratat e punëtorëve, ku sipas OE ankues ka falsifikuar numrin unik.

Eksperti shqyrtues sqaron se nuk kemi autorizim/kompetencë e as kapacitet profesional për të shqyrtuar një pretendim të tillë ankimorë, dhe OE ankues për një pretendim të tillë ankimorë mendojmë se do duhej drejtuar organeve kompetente.

Pretendimi nr.4

OE ankues sipas ankesës ka pretendime edhe për OE tjetër pjesëmarrës “Rea shpk”. Me gjithë se në ankesë nuk është lëshuar në detaje, sipas kërkesës për rishqyrtim ka kontestuar disa pika të ofertës të këtij OE, ku një ndër to është edhe letër mbështetje nga banka e cila sipas OE ankues nuk është në pajtim me kërkesat e dosjes.

Pas analizimit të ofertës së OE Rea sh.p.k, kemi gjetur se sa i përket kërkesës për mjete të gatshme ose qasje në kredi të pakushtëzuar, është situatë identike me OE e rekomanduar për kontratë, dhe mendimi ekspertit është OE Rea shpk nuk e plotëson kërkesën për mjete të gatshme ose qasje në kredi të pakushtëzuar.

Për më tepër, në të njëjtën letër banka thekson se, nuk ka dhe nuk pranon asnjë përgjegjësi financiare ndaj përfituesit dhe/ose autoritetit kontraktues.

Provë : Letër Mbështetja (e kushtëzuar) nga banka për OE "REA" shpk

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimorë në këtë pikë është i bazuar.

Pretendimi nr.5

Pretendimi i fundit ankimorë sipas ankesës 760/22 është se nuk qëndron pretendimi i AK-së se anëtar i grupit të "Pe-Vla-Ku dega në Kosovë" është tërhequr nga konzorciumi.

OE ankues pretendon se :

"Letrën sqaruese që AK ka bashkangjitur, e të cilën e ka dërguar partneri ynë i konzerciumit vërehet se është dërguar dhe nënshkruar nga z.Vladimir Pjetërgjokaj, ku ne si Lider gjithë komunikimin edhe nënshkrimin e dokumentacioneve e kemi bërë me përfaqësuesin ligjorë për Degën në Kosovës z.Arben Sadrija...".

Gjatë analizimit të shkresave të lëndës kemi gjetur se kompania Pe-Vla-ku shpk Dega në Kosovë me 24.10.2022 ka dërguar shkresë AK-së, përmes së cilës i njëjti deklaron se Tërhiqet nga konzorciumi.

Kjo shkresë (e vulosur) e kompanisë është nënshkruar nga Vladimir Pjetërgjokaj.

Ne kemi hulumtuar më tutje përmes faqes zyrtare të ARBK-së, dhe tek të dhënat "Përfaqësues i Autorizuar" kemi gjetur se Valdimir Pjetërgjokaj është "Drejtore" i kompanisë.

Provë : Përfaqësuesit e "Pe-Vla-Ku SH.P.K Dega në Kosovë" – të dhënat nga ARBK

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë se në rastin konkret kemi të bëjmë me ndryshim të grupit të OE-ve, gjë e cila shprehimisht është e ndaluar me rregullat e prokurimit publik : "Grupi i OE nuk do të modifikohet pas dorëzimit të tenderit (fazës së vlerësimit), nëse ndodhë kjo atëherë tenderi do të refuzohet...".

Kjo dispozitë është e njëjtë si me Rregullore nr.001/22 për prokurim publik neni 26.11, ashtu edhe me RRUOPP të viti 2021 neni 27.5.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart vlerësojmë pretendimi ankimorë i OE ankues në këtë pikë është i pabazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues të prokurimit

Duke u bazuar në të gjeturat, krahasimet, faktet, dokumentet e shqyrtuara dhe të cekura në këtë ekspertizë, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues të OSHP-së që ankesa e OE të aprovohet pjesërisht e bazuar, në të njëjtën kohë rekomandojmë që në mungesë të ofertave të përgjegjshme të anulohet vendimi i AK-Komuna e Gjakovës dhe të anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit, dhe nëse AK edhe më tutje ka interes për zhvillim të këtij aktiviteti lëndën ta kthejë në ri tenderim.

Konstatimet e panelit shqyrtues

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) dhe ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor me dt. 13.02.2023 me qëllim të vlerësimit të drejtë të çështjes.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët, deklaratat e palëve në proces, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli. Andaj, në mungesë të ofertave të përgjegjshme ky aktivitet i prokurimit duhet të anulohet.

Paneli Shqyrtues, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike sa i përket tërheqjes nga konzorciumi, me datën 13.02.2023, ishte drejtuar me anë të postës elektronike OE Pevlaku me kërkesën si në vijim cituar: *Ju OE keni ofertuar ne aktivitetin e prokurimit me titull: Rregullimi I shtratit te Lumit Krena, me nr te prokurimit: 632/22/7920/511, se bashku me OE VB Tofaj Shpk – si konzorciumi, OSHP, ne platformën e E-Prokurimit ka vërejtur një shkresë, por edhe ne përgjigjen e AK-se ne kërkesën për rishqyrtim se ju jeni TERHEQUR nga konzorciumi ne formën e sqarimit. Kërkojmë nga ju një konfirmim deklarative, lidhur me tërheqjen tuaj nga konzorciumi.* Ndërsa, OE Pevlaku shpk, më dt. 13.02.2023, kthen përgjigje duke e bashkangjitur dokumentin, duke deklaruar:

Kompania "PE-VLA-KU" Sh.P.K – Dega ne Kosove është njëra ndër kompanitë e cila ka marre pjese ne shume projekte gjate vitit 2022, vetëm dhe ne konzercium. Por për arsyeje ekonomike dhe për arsye se autoriteti kontraktues si ministritë dhe komunat nuk janë te rregullta ne pagesa te punëve te kryera dhe për shkak te mungesës se fondeve te pamjaftueshëm ne kemi vendosur qe te tërhiqemi nga te gjitha projektet vetëm dhe ne konzerciumi qe kemi ofertuar dhe i kemi marre gjate vitit 2022.

Ne baze te realizimit te vitit 2022 borxhi i akumuluar nga autoriteti kontraktuese : ministrit dhe komunat për kompaninë tone mbërrin shumen afër 5.000.000,00€ (pese milion euro), borxh i cili nuk është paguar dhe kjo është arsyeja kryesore se pse ne kompania "PE-VLA-KU" Sh.P.K – Dega ne Kosove tërheqet nga te gjitha projektet e ofertuar vetëm dhe ne konzerciumi.

Këto janë arsyeja e tërheqjes tona nga projektet.

Kur kemi të bëjmë me tërheqje nga Grupi i OE e njërit anëtar në këtë fazë (faza e vlerësimit), atëherë kjo gjendje është e paraparë me dispozitën ligjore, konkretisht nenin 27.5 të RRUOPP.

Paneli shqyrtues me marrjen e vendimeve gjithmonë ka parasysh nenin 1 të LPP-së, ku qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Vendimi sikurse në pikën 2, të dispozitivit është marrë në kuptim të nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores së punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, meqenëse pretendimet ankimore janë të bazuara dhe rrjedhimisht ky aktivitet i prokurimit anulohet.

Paneli Shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat POTERQOI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK Komuna Gjakovë
- 1x1 OE "V.B Tofaj" me seli në Junik
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.